



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.394/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Muhamet Selmani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave me postë, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 07.11.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.394/2025, e datës 05.11.2025, e parashtruar nga Muhamet Selmani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave me postë, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025

A r s y e t i m

Më datë 05.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.394/2025, nga Muhamet Selmani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën theksohet se duke u bazuar në web faqen e KQZ dhe rezultatet e publikuara me datë 03.11.2025, tek rubrika “Me postë”, për subjektin Partia Demokratike e Kosovës (PDK), votat për kandidat, te rreshti nr.17 për kandidatin Muhamet Selmani figuron vetëm një votë, dhe se paku janë tre dëshmitar që deklarojnë se kanë votuar për kandidatin Muhamet Selmani, deklaratat e të cilëve janë bashkangjitur ne ankese, thekson parashtruesi i ankesës. Po ashtu parashtruesi thekson se kam edhe katër dëshmitare të tjerë që deklarojnë se ata kanë votuar për kandidatin Muhamet Selmani, mirëpo për arsye të procedurave nuk kanë mundur të i dërgojnë edhe deklaratat dhe dokumente tjera për ankese por vetëm dëftesat e regjistrimit për votim me poste për secilin nga

këta votues. Parashtruesi kërkon nga PZAP, që të aprovoj ankesën dhe të behet edhe njëherë verifikimi i votave me poste, si dhe verifikimi i këtyre votave të këtyre dëshmitareve.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, theksohet se: procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, (Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve. Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: 17. Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike. Pritjet e palës ankuese për të marrë më shumë vota nga votimi jashtë Kosovës automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe Llogaritja matematikore nuk argumenton shkeljet e pretenduara.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë konstaton se:

- *Ankesa është e pabazuar.*

Paneli pas shqyrtimit të ankesës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e ankuesit Muhamet Selmani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik PDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet fakti me prova konkrete se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave sa i përket votave të dërguara me postë nga diaspora. Sipas vlerësimit të panelit vetëm pretendimi nga ankesa se “bazuar në web faqen e KQZ dhe rezultatet e publikuar me datë 03.11.2025, tek rubrika “Me postë”, për subjektin Partia Demokratike e Kosovës (PDK), votat për kandidat, të rreshti nr.17 për kandidatin Muhamet Selmani figuron vetëm një votë, dhe se paku janë tre dëshmitar që deklarojnë se kanë votuar për kandidatin Muhamet Selmani, deklaratat e të cilëve janë bashkangjitur në ankese, dhe se kam edhe katër dëshmitarë të tjerë që deklarojnë se ata kanë votuar për kandidatin Muhamet Selmani, mirëpo për arsye të procedurave nuk kanë

mundur të i dërgojnë edhe deklaratat dhe dokumente tjera për ankese por vetëm dëftesat e regjistrimit për votim me poste për secilin nga këta votues”, sipas vlerësimit të panelit këto pretendime janë të pabazuara për faktin se parashtuesi i ankesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij me prova konkrete, edhe vet ankuesi nuk është i sigurtë në pretendimet e tij të cilat paraqiten më shumë si hamendësime të tij se sa pretendime reale, andaj rrjedhimisht nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në kuptim, paneli, në mungesë të dëshmive nuk mund të vërtetojë se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështetet në deklarin e disa personave - respektivisht në deklarin e votuesve, të identifikuar me emër dhe mbiemër. Paneli vlerëson se qëndron fakti se është e drejtë e votuesit që pas votimit të deklarohet lirshëm lidhur me votën e tij, apo që të interesohet për votën e tij, por mënyra e të provuarit respektivisht dëshmitë e ofruara nuk i përmbushin as kushtin formal dhe as atë përmbajtësor të konsiderohet provë bindëse për procedim dhe hetim të mëtutjeshëm apo për hapjen e kutive të votimit.

Po ashtu paneli vlerëson se është e pa kontestuar se bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjer sa shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë votës.

Neni 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton se *“Liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë në një mënyrë, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim”*.

Mirëpo do të duhej cekur se lidhur me deklaratat e votuesve dhe fshehtësisë së votimit, është krijuar tashmë praktika gjyqësore nga se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025 të datës 24.03.2025 kishte konstatuar se *“Deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kanë votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit”*.

Paneli vlerëson se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesat e paraqitura, parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë me prova konkrete, të ligjshme se ka pasur mungesë të votave, andaj Paneli vlerësoj nuk është provuar me asnjë provë se ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e

Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.394/2025 më datën 07.11.2025

Kryesues i Panelit,
Arsim Hamzaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LJP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.